

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM  
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA  
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD  
FERIZAJ I UROŠEVAC

Më  
Dana

05 - 03 - 2018

P.nr.886/17

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**, në përbërje nga gjyqtarja individuale Hakile Ilazi, me Zyrtaren Ligjore Ganimete Avdiu në lëndën penale kundër të akuzuarve, [REDAKTUAR], dhe [REDAKTUAR] për shkak të veprës penale në bashkëkryerje kryen veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.344-1/15 të datës 05.04.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prani të prokurorit të shtetit Ismet Rrahmani, të akuzuarit me 15.01.2018, shpall dhe publikisht komunikon këtë:

### A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna [REDAKTUAR], i lindur me [REDAKTUAR] në të njëjtin vend, nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], I martuar, baba i dy fëmijëve, i punësuar në botën e jashtme – në shtetin Zvicran shqiptar, shtetas i Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën mesme .

I akuzuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna [REDAKTUAR], i lindur me [REDAKTUAR] në të njëjtin vend, nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], i martuar, babë i dy fëmijëve, i punësuar në botën e jashtme – në shtetin Austriak, shqiptar, shtetas i Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme,

### Janë fajtorë

Se me datën 03.03.2015 rreth orës 13:00 në fshatin Dardani pn. Komuna Ferizaj pikërisht në qendrën tregtare “Viva Fresh Store” në Ferizaj, të pandehurit pas një marrëveshje lidhur me probleme familjare, pasi që i dëmtuari [REDAKTUAR], kishte qen i fejuar dhe ishte ndarë me motrën e të pandehurit [REDAKTUAR], fillimisht kishin pasur një konflikt verbal e më pas të pandehurit dhe atë [REDAKTUAR] me një shufër të hekurt dhe [REDAKTUAR] me një çekan

–mjete këto të përshtatshme për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor e sulmojnë të dëmtuarin duke goditur në kokë dhe shpinë, me të cilin rast i dëmtuari pëson lëndime të lehta trupore ndrydhe e indeve të buta të kokës, lëndime këto me pasoja të përkohshme të shëndetit të përshkruara në ekspertizën mjeko ligjore të datës 19.03.2017.

me të cilën kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së

Andaj gjykata ne baze të neneve 4,6,17,21,41, 42,43,46 dhe 73 të KPRK-së, si dhe neni 365 të KPPK-së, shqipton:

## GJYKON

Të akuzuarve :

1. [REDAKTUAR] i cakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4/ katër/muaj muaj i cili dënim konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit i zëvendësohet në dënim me gjobë në lartësi prej 300 € (treqind euro), të cilën shumë detyrohet që ta paguaj në afat prej 30 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merrë formën e prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 par. 4 të KPRK-së, i njëjti do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 €, do të vuaj një ditë burgimi.

2 [REDAKTUAR] i cakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 4/katër/muaj muaj i cili dënim konform nenit 47 të KPRK-së, me pëlqimin e të pandehurit i zëvendësohet në dënim me gjobë në lartësi prej 300 € (treqind euro), të cilën shumë detyrohet që ta paguaj në afat prej 30 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merrë formën e prerë.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyra tjera të parapara në nenin 46 par. 4 të KPRK-së, i njëjti do të ekzekutohet në atë mënyrë që i akuzuari për çdo 20 €, do të vuaj një ditë burgimi.

I dëmtuari [REDAKTUAR] nga Fshati [REDAKTUAR] Komuna [REDAKTUAR], për kompensimin e dëmit, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 20 euro ( njëzetë euro ) si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 25 /njëzetë e pesë /€ në afat prej 30 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

### A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzë PP/.nr. ka akuzuar PP/II.nr.344-1/15 të datës 05.04.2017 të akuzuarit: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale në bashkëkryerje kryen veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti shqyrtimin fillestar me datë 15.01.2018, në të cilën shqyrtim të akuzuarit janë deklaruar fajtor për veprën për të cilën e ngarkon akuzat, I akuzuari [REDAKTUAR], duke e shprehur pendim real dhe të sinqertë për veprën penale të kryer, duke shtuar se i dëmtuari kishte qen i fejuar me motrën e tij dhe i njëjti ishte ndarë nga motra e tij e në shejë revolte ja kishte shkaktuar lëndimet të dëmtuarit, i premtonte gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra të tilla apo të ngjashme penale, i ka propozuar gjykatës që ti shqiptoj një dënim sa më të butë.

I akuzuari [REDACTED], duke e shprehur pendim real dhe të sinqertë për veprën penale të kryer, duke shtuar se i dëmtuari kishte qen i fejuar me motrën e tij dhe injëjti ishte ndarë nga motra e tij, duke shtuar se i njëjti punon dhe jeton në shtetin e Austrisë. e i premtion gjykatës qe ne te ardhmen nuk do të përsërisë vepra te tilla apo te ngjashme penale, i ka propozuar gjykatës qe ti shqiptoj një dënim sa me te butë.

Pasi që i akuzuari ka pranuar fajësinë, Gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë dhe shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par. 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se, i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit dhe atë:

Mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko ligjor i datës 19.03.2017, deklaratat e të pandehuravetë datës 10.03.2015, deklarata e të dëmtuarit të datës 03.03.2015 dhe deklarata e dëshmitarit të datës 03.03.2015.

Meqenëse të akuzuarit kanë pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e përshkruara më lartë, andaj gjykata konform nenit 248 paragrafit 4 të KPPK-së, ka vlerësuar se nuk është e nevojshme vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqiptimin e dënimit dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

---

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale në bashkëkryerje kryen veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarit, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 73 të KPRK-ës dhe gjeti si rrethanë veçanërisht lehtësuese se të akuzuarit kanë pranuar fajësinë. I akuzuari [REDACTED], duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, është baba i dy fëmijëve, përkatësisht mbajtës i familjes, nuk është i njohur më parë si kryes i veprave penale, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, vetë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe rrethanat në të cilën ndodhur ngjarja, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

I akuzuari [REDAKTUAR], duke e shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer, dhe nuk është i njohur më parë si kryes i veprave penale, baba i dy fëmijëve, përkatësisht mbajtës i familjes, nuk është i njohur më parë si kryes i veprave penale, në rastin konkret nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese, vetë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe rrethanat në të cilën ka ndodhur ngjarja, përveç që vlerësoj shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si dhe rrezikshmërinë konkrete të veprës penale.

Gjykata është bindur se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarës dhe me dënimin e shqiptuar me gjobë do të arrihet qëllimi i dënimit siç parashihet ne dispozitat e nenit 41 të KPRK-së. që do të shërbej në parandalimin e kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

Konform nenit 458,459 dhe 460 I dëmtuari [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] Komuna [REDAKTUAR], për kompenzimin e dëmit, udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Konform nen. 450 dhe 451 të KPPK-së, Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale në mënyrë solidare të paguaj shumën prej 20 euro ( njëzetë euro ) si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën secili veç e veç me nga 25 /njëzetë e pesë /€ në afat prej 30 ditësh, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.


Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**

**P.nr. 886/17me datë 15.01.2018**


**Zyrtarja ligjore,**

Ganimete Aydiu



**Gjyqtarja Individuale,**

Hakile ILAZI



**Këshilla juridike:** kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Kosovës, në afat prej 15/pesëmbëdhjete/ditësh. Kurse të dëmtuarit mund të paraqesin ankesë vetëm sa i përket vendimit për sanksionin penal nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate.